



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 nëntor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit (F00342)

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së të akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykses) lëshon këtë vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit (F00342).

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 20 shtator 2022, Mbrojtja e Pjetër Shalës (përkatësisht Mbrojtja dhe i akuzuari) dorëzoi një kërkesë me anë të së cilës kërkonte, ndër të tjera, përjashtimin nga dosja e çështjes gjyqësore të të gjitha deklaratave që i akuzuari u kishte dhënë zyrtarëve të ndryshëm në vitin 2016 dhe 2019, si dhe të materialeve të tjera të lidhura me to (Kërkesa e Mbrojtjes).¹
2. Më 30 shtator 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) u përgjigj ndaj Kërkesës së Mbrojtjes,² dhe më 7 tetor 2022 Mbrojtja dorëzoi kundërpërgjigjen e saj.³
3. Më 20 tetor 2022, Trupi Gjykses e urdhëroi ZPS-në të paraqiste parashtrime të tjera lidhur me themelësinë e Kërkesës së Mbrojtjes deri më 1 nëntor 2022.⁴
4. Më 28 tetor 2022, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e ZPS-së⁵ për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve të parashtrimeve të saj të ardhshme.⁶

¹ KSC-BC-2020-04, F00281, Mbrojtja, *Mocion për Përjashtimin e Provave nga Dosja e Çështjes Gjyqësore që do t'i Kalohet Trupit Gjykses*, 20 shtator 2022, konfidencial, para. 1, me Shtojcat 1-3, konfidenciale.

² KSC-BC-2020-04, F00288, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Mbrojtjes për Përjashtimin e Provave nga Dosja e Çështjes Gjyqësore*, 30 shtator 2022, konfidenciale.

³ KSC-BC-2020-04, F00299, Mbrojtja, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mocionin e Mbrojtjes për Përjashtimin e Provave nga Dosja e Çështjes Gjyqësore*, 7 tetor 2022, konfidenciale.

⁴ KSC-BC-2020-04, Transkript i Seancës, 20 tetor 2022, konfidencial, f. 495, rreshti 4 deri f. 495, rreshti 18.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00327, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 27 tetor 2022, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00330, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 28 tetor 2022, konfidencial.

5. Më 1 nëntor 2022, ZPS-ja dorëzoi parashtrimet dhe i kërkoi Trupit Gjykses që të pranoheshin si prova materialet e kundërshtuara, si dhe dy deklarata të mëparshme të të akuzuarit dhe materialet e lidhura me to (Kërkesa e ZPS-së).⁷
6. Më 9 nëntor 2022, Mbrojtja i kërkoi Trupit Gjykses të miratonte zgjatjen prej 10 ditësh të afatit për t'iu përgjigjur Kërkesës së ZPS-së (Kërkesa e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit).⁸
7. Më 10 nëntor 2022, ZPS-ja u përgjigj duke thënë se nuk kundërshtonte Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Trupi Gjykses mban parasysh nenet 40(2) dhe (6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 9(5)(a) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

III. DISKUTIM

9. Fillimisht, Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit është dorëzuar mjaftueshmërisht në kohë para afatit për përgjigje ndaj Kërkesës së ZPS-së, konkretisht me 14 nëntor 2022.
10. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se, në përputhje me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, Mbrojtja ka dhënë arsye bindëse duke pasur parasysh se ajo ka shpjeguar

⁷ KSC-BC-2020-04, F00334, Prokurori i Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarit*, 1 nëntor 2022, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00342, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit të Dorëzimit të Përgjigjes j ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarit*, 9 nëntor 2022, konfidenciale.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00343, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit*, 10 nëntor 2022, konfidenciale.

bindshëm se duhet t'u përmbahet disa afateve procedurale për dorëzimin e parashtrimeve mbi një numër aspektesh të rëndësishme, konkretisht më 11, 14 dhe 16 nëntor 2022. Për më tepër, Trupi Gjykses kupton nga Mbrojtja se ajo është angazhuar në një debat juridik para Panelit të Gjykatës Kushtetuese.¹⁰

11. Në të njëjtën kohë, Trupi Gjykses rikujton se afati i ardhëm për rishikimin e mbajtjes në paraburgim të të akuzuarit është më 21 nëntor 2022,¹¹ ndërkohë që Mbrojtja kërkon që afati i përgjigjes së saj ndaj Kërkesës së ZPS-së të shtyhet deri më 24 nëntor 2022.¹² Duke pasur parasysh se Mbrojtja kërkon që të mos përfshihen deklaratat e dhëna nga ai akuzuari në vitin 2016 dhe 2019, për *asnjë* qëllim, përfshirë rishikimin e paraburgimit,¹³ Trupi Gjykses gjykon se është mirë të gjejë zgjidhje debati lidhur me Kërkesën e Mbrojtjes para rishikimit të paraburgimit të të akuzuarit.

12. Bazuar në sa më lart, në rast se i akuzuari dëshiron të mos e ushtrojë të drejtën që të rishikohet mbajtja e tij në paraburgim në afatin e parashikuar dhe të kërkojë të shtyhet rishikimi i paraburgimit deri në momentin kur Trupi Gjykses të ketë nxjerrë vendimin e tij mbi Kërkesën e Mbrojtjes (gjithsesi jo më vonë se 6 dhjetori 2022), Mbrojtja duhet të dorëzojë një njoftim të heqjes dorë bashkë me një shtojcë që përmban një mocion të heqjes dorë të nënshkruar nga i akuzuari, jo më vonë se **të mërkurën, 16 nëntor 2022 (16:00)**. Si alternativë, Trupi Gjykses do të vazhdojë të rishikojë mbajtjen në paraburgim të të akuzuarit, sipas nenit 41(10) të Ligjit, duke marrë parasysh deklaratat dhe materialet e lidhura me to të cilat janë objekt i debatit juridik aktual.

¹⁰ Kërkesa e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit, para. 6.

¹¹ KSC-BC-2020-04, F00282, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 21 shtator 2022, konfidencial. *Shih më tej* KSC-BC-2020-04, F00284/A03, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Dokumenti i Dorëzimit*, 21 shtator 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 20.

¹² Kërkesa e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit, para. 8.

¹³ *Shih* Kërkesa e Mbrojtjes, para. 41 dhe F00341, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e Tetë të Paraburgimit*, 8 nëntor 2022, konfidenciale, para.17.

E premtë, 11 nëntor 2022

Hagë, Holandë.